

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2914/3 Prot.

Durrës, më 11.12.2025

VENDIM
Nr. 113, datë 11.12.2025

PËR
"PËR MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË NUMRIT TË STUDENTËVE
CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË, QË PËRJASHTOHEM NË MASËN 50% NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026"

Në mbështetje të nenit 4 "e drejta e studimit", nenit 49 "Funksionet e bordit të Administrimit", nenit 98 "të drejtat dhe detyrimet e studentëve" të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Përfshirjen në masën 50%, nga tarifa vjetore e shkollimit, studentët të cilët vijojnë studimet në ciklin e dytë me kohë të plotë viti akademik 2025-2026 pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të cilët vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë, 170 studentë efekti financiar 5,874,000 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:

- Administratori
- Drejtoria e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

